



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
SENATI AKADEMIK

V E N D I M

Nr. 12, datë 18.11.2021

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT ME UNIVERSITETIN "EQREM
ÇABEJ" GJIROKASTËR, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË
ANTROPOLOGJI

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 80 pika 1, Statutit të Akademisë së Studimeve Albanologjike, VKM-së Nr. 185 datë, 25.03.2021, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë" Kreu IV/A "Dokumentacioni dhe procedura për hapjen e programeve të studimit", Vendimit të Njesisë bazë, Nr. 68 Prot, 16.11.21, Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike, në mbledhjen e tij të datës, 18.11.2021;

V E N D O S I:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët në ciklin të parë "Bachelor" në Antropologji, me 180 ECTS, i shtrirë në 3 (tre) vite akademike në sistemin me kohë të plotë, në bashkëpunim me Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Ky program studimi do të ofrohet nga Departamenti i Etnologjisë, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Njësia bazë e Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin "Eqrem Çabej".

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR LUAN PËRZHITA

